STRATEGJIA

AFATMESME E ZHVILLIMIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR PERIUDHËN

2013-2015

Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike në adresën:

www.bankofalbania.org

Në qoftë se dëshironi të keni kopje të shkruara të tij mund t'i kërkoni në adresën:

Banka e Shqipërisë, Sheshi "Avni Rustemi", Nr.24, Tiranë, Shqipëri,
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419409/10/11
Faks: + 355 4 2419408

ose duke dërguar një e-mail në adresën:

public@bankofalbania.org

Tirazhi: 900 kopje
Shtypur në shtypshkronjën ALBDESIGN

PËRMBAJTJA

FJALA E GUVERNATORIT 5
HYRJE 7
POLITIKA MONETARE 10
REZULTATI I DËSHIRUAR 10
OBJEKTIVI 10
KURSI I KËMBIMIT 11
INSTRUMENTET 11
PRIORITETET 12
VLERËSIMI I PERFORMANCËS 12
STABILITETI FINANCIAR 14
MBIKËQYRJA BANKARE 16
INFRASTRUKTURA FINANCIARE 19
SISTEMET E PAGESAVE 19
EMETIMI I PARASË 21
STATISTIKAT 23
STATISTIKAT E SEKTORIT MONETAR 24
STATISTIKAT E LLOGARIVE FINANCIARE 24
STATISTIKAT E SEKTORIT TË JASHTËM 24
STATISTIKAT E SEKTORIT MONETAR 25
STATISTIKAT E SEKTORIT TË JASHTËM 25
REZULTATE TË PRITSHME 25
STATISTIKAT E SEKTORIT MONETAR 25
STATISTIKAT E SEKTORIT TË JASHTËM 25
STRUKTURA, STATUSI, LLOGARIDHËNIA 27
PAVARËSIA DHE QEVERISJA 27
QEVERISJA 28
LLOGARIDHËNIA 29
KOMUNIKIMI 30
INTEGRIMI EVROPIAN 36
BURIMET NJERËZORE DHE FINANCIARE 38
BURIMET NJERËZORE 38
BURIMET FINANCIARE 39
BURIMET MATERIALE 40
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR 42

FJALA E GUVERNATORIT

Strategjia afatmesme e zhvillimit synon të paraqesë qartësisht vizionin për orientimin e Bankës së Shqipërisë drejt Sistemit Evropian të Bankave Qendrore, duke përcaktuar objektivat dhe identifikuar masat e burimet e nevojshme për përmbushjen e tyre. Strategjia është një instrument i rëndësishëm për organet vendimmarrëse dhe drejtuesit e Bankës së Shqipërisë, pasi identifikon hapësirat për përmirësim të mëtejshëm në punën tonë. Ky dokument është veçanërisht i dobishëm në përballjen me ndryshimet e parreshtura në mjedisin në të cilin operon Banka e Shqipërisë dhe një mjet i rëndësishëm për forcimin e marrëdhënieve tona institucionale me organet e tjera shtetërore, dhe publikun në tërësi.

Identifikimi realist i sfidave kryesore me të cilat pritet të përballet Banka e Shqipërisë gjatë periudhës trevjeçare në vijim, do të mundësojë marrjen e masave proaktive në kohën e duhur. Përmes paraqitjes së qartë të angazhimeve të ardhshme, ky dokument synon të jetë i fokusuar dhe i pranuar gjerësisht nga të gjitha palët e interesuara, si dhe praktik dhe i drejtpërdrejtë për t'u zbatuar.

Strategjia siguron që veprimtaritë e institucionit të përqendrohen në përmbushjen e detyrave të tij ligjore, veçanërisht ato që lidhen me stabilitetin monetar dhe atë financiar, të cilët përbëjnë dy shtyllat e veprimtarisë së një banke qendrore moderne. Gjatë hartimit të strategjisë jemi përpjekur të përfshijmë punonjësit e të gjitha niveleve, me qëllim që personeli i Bankës së Shqipërisë të jetë sa më i angazhuar ndaj institucionit. Secili punonjës është ftuar të shohë përtej rutinës së përditshme të punës, për të ofruar perspektivën vetjake mbi sfidat aktuale dhe faktorët e brendshëm e të jashtëm, që mund të ndikojnë mbi punën tonë në të ardhmen. Në këtë mënyrë, është përfituar nga përvoja e gjithsecilit për ta bërë strategjinë më të lehtë për t'u zbatuar.

Forcimi dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore e institucionale për përmbushjen e objektivave të parashikuar përbën një instrument thelbësor për zbatimin e strategjisë. Për këtë arsye, theksi është vënë në përqendrimin e përpjekjeve tek detyrat themelore të Bankës së Shqipërisë dhe krijimin e një kulture pune të

denjë për një institucion të politikës publike, si një faktor kyç në përmbushjen e objektivave strategjikë.

Krahas së qenurit një mjet i rëndësishëm për drejtimin e institucionit, strategjia është një instrument për forcimin e përgjegjësisë dhe transparencës ligjore të Bankës së Shqipërisë. Realizimi me sukses i saj i shërben planifikimit vjetor buxhetor të institucionit. Së fundmi, publikimi i këtij dokumenti kontribuon në nxitjen e të kuptuarit dhe ankorimin e pritshmërive të publikut ndaj institucionit tonë, duke e edukuar këtë të fundit mbi rolin dhe përgjegjësitë e Bankës së Shqipërisë në ekonominë e vendit.

Ardian Fullani

HYRJE

Strategjia afatmesme e Bankës së Shqipërisë për periudhën 2013-2015 ka për qëllim të ofrojë një përgjigje proaktive ndaj sfidave në mjedisin në të cilin operon banka qendrore; të promovojë bashkëpunimin brenda institucionit; të nxisë përdorimin efektiv dhe efecient të burimeve; si dhe të promovojë llogaridhënien e Bankës. Ky dokument synon të jetë një plan jo vetëm vizionar, por edhe konkret për t'u zbatuar dhe transparent për sa u përket planifikimit dhe rezultateve për t'u arritur, si dhe një mjet komunikimi qe i flet punonjësve te Bankës dhe qindra të interesuarve të tjerë. Ai organizohet sipas një strukture që jep qartë veprimtarinë shtytëse të brendshme dhe rezultatet e jashtme, dhe bën të mundur matjen sasiore dhe cilësore të suksesit ose mossuksesit në përmbushjen e masave të parashikuara në strategji.

Për sa më sipër, strategjia shpalos sfidat kryesore me të cilat do të përballet Banka gjatë periudhës trevjeçare në vijim. Në identifikimin e këtyre masave janë përfshirë jo vetëm niveli drejtues i departamenteve, por edhe personeli në përgjithësi. Kjo është bërë në përputhje me strukturën organizative të Bankës dhe duke siguruar kështu lidhjet e duhura me buxhetin afatmesëm.

Për periudhën 2013-2015, politika monetare e Bankës do të vazhdojë të orientohet drejt arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, duke synuar njëkohësisht minimizimin e kostove të veprimit të saj mbi sektorin real dhe atë financiar të ekonomisë. Banka synon të përmirësojë vendimmarrjen e politikës monetare, në interes të rritjes së efektivitetit të saj dhe në përgjigje të sfidave të zhvillimeve të ekonomisë së brendshme dhe asaj botërore. Ky përmirësim do të realizohet nëpërmjet rritjes cilësore të instrumenteve të analizës dhe të parashikimit, si dhe nëpërmjet forcimit të koordinimit të politikës monetare me atë fiskale dhe me masat makroprudenciale.

Banka do të vendosë objektivin për zhvillimin e politikave të përshtatshme makroprudenciale në qendër të veprimtarisë së saj dhe të bashkëpunimit ndërinstitucional. Zhvillimi i politikave të përshtatshme makroprudenciale, lidhet me identifikimin dhe zbatimin e masave kryesisht prudenciale për parandalimin, kufizimin dhe trajtimin e rreziqeve financiare sistemike. Kuadri i politikave makroprudenciale do të mbështetet mbi parimet e konsoliduara të pavarësisë institucionale dhe ruajtjes së objektivit kryesorë të veprimtarisë së Bankës. E udhëhequr nga këto parime, Banka do të nxisë diskutimin dhe vendimmarrjen për veprime të natyrës makroprudenciale që gjejnë mbështetje tek instrumentet e konsoliduara të politikës monetare.

Mbikëqyrja bankare do të vijojë të ketë si objektiv themelor sigurimin e një veprimtarie bankare të shëndetshme në vend, e cila garanton sigurinë e kursimeve të qytetarëve, mbështet stabilitetin financiar dhe kontribuon në ecurinë pozitive të ekonomisë në tërësi. Procedurat mbikëqyrëse do të strukturohen më tej mbështetur në standardet ndërkombëtare dhe analizën e rreziqeve, në përputhje me nivelin e sofistikimit në rritje të veprimtarisë bankare, duke siguruar bazën për identifikimin dhe vlerësimin e çdo rreziku material. Zhvillimi i kuadrit rregullator do të vijojë të jetë i orientuar drejt objektivit themelor të përafrimit me Bazel II/III dhe direktivat e Bashkimit Evropian.

Banka do të ketë në fokus të saj përmirësimin e infrastrukturës financiare si një faktor i rëndësishëm për stabilitetin financiar në vend. Veçanërisht në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës së Regjistrit të Kredive nëpërmjet modernizimit, zgjerimit të gamës së informacionit dhe shërbimeve të ofruara si dhe përfshirjes të sa më shumë subjekteve huadhënëse.

Ngritja e një regjistri qendror të titujve (CSD) dhe integrimi i tij me sistemet aktuale të shlyerjes (AIPS) dhe klerimit (AECH), të cilat operohen nga Banka e Shqipërisë përbën një ndërmarrje të rëndësishme në modernizimin e infrastrukturës bankare. Ajo jo vetëm do të automatizojë një sërë procesesh, por do të sigurojë një informacion të detajuar për mbikëqyrjen e transparencën e transaksioneve financiare e mbrojtjes së klientëve.

Rritja e mëtejshme e cilësisë së statistikave dhe analizave të prodhuara nga Banka e Shqipërisë do të mbështetet edhe me modernizimin e infrastrukturës së raportimit të bankave. Kjo infrastrukturë do të ndërtohet me kontributin e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Me synim nxitjen e sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit kombëtar të pagesave, Banka do të intensifikojë përpjekjet në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës, me qëllim shtrirjen gjithnjë e më të madhe të përdorimit të tyre nga publiku. Roli mbikëqyrës në sistemin e pagesave do të fuqizohet përmes ridimensionimit të tij në një rol më aktiv dhe të kujdesshëm, sipas praktikave më të mira ndërkombëtare dhe evropiane pas krizës financiare globale. Gjithashtu do të punohet për përmirësimin e infrastrukturës, nga ana teknike dhe rregullative, me qëllim përafrimin me praktikat më të mira evropiane dhe njëkohësisht rritjen e sigurisë dhe eficiencës, me synim promovimin e masës së përdorimit të sistemit nga publiku.

Banka synon të sigurojë që cilësia e kartëmonedhave në qarkullim të jetë e mirë dhe e pranueshme, me qëllim rritjen e besueshmërisë për publikun dhe mbrojtjen e integritetit të kartëmonedhave. Përmes Qendrës Kombëtare të Analizës, Banka do të rikonceptojë përqasjen ndaj falsifikimit të parasë, duke filluar nga aspektet ligjore, administrative, laboratorike dhe deri tek edukimi i publikut në çështjet e falsifikimit.

Nga pikëpamja organizative, do të synohet forcimi i pavarësisë së Bankës, në përputhje me standardet e Traktatit të Bashkimit Evropian dhe Statutit të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore, si dhe rritja e bashkëpunimit me organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe institucionet e pavarura. Gjithashtu, do të vijojë puna për përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit bankar me acquis e Bashkimit Evropian, sidomos në fushat e shërbimeve bankare, lëvizjeve të kapitalit dhe parandalimit të pastrimit të parave dhe mbrojtjes së konsumatorit.

Në fokus të veprimtarisë së Bankës do të jetë edhe forcimi dhe ruajtja e një mjedisi pune motivues për punonjësit, rritja profesionale dhe menaxhimi i karrierës, duke krijuar një kulturë pune të aftë për t'u përshtatur në mënyrë të vazhdueshme me ndryshimet që kërkohen për arritjen e standardeve më të mira për një bankë qendrore, si dhe një qëndrueshmëri dhe vazhdueshmëri afatgjatë të kapaciteteve administrative dhe të punës në Bankë.

Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS) është një tjetër sfidë e Bankës. Zbatimi i tyre lidhet ngushtë me të gjithë punën operacionale dhe administrimin e të dhënave në Bankë, sistemet informatike dhe përmirësimin e tyre, strukturën mbështetëse organizative, ndjekjen dhe kontrollin e rrezikut operacional, rritjen e nivelit të kualifikimit të punonjësve si dhe tregimin e kujdesit të duhur në të gjitha fushat.

Së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, gjatë periudhës afatmesme do të vijojë puna për përfundimin me sukses të projektit të rikonstruktimit të ndërtesës qendrore të Bankës, duke e zgjeruar dhe rikthyer atë në origjinalitet. Ndërtesa e rikonstruktuar do të mundësojë mjedise të përshtatshme për një muze modern me funksione të integruara numizmatike, historike dhe edukuese. Kompozimi dhe projektimi i muzeut do të respektojë arkitekturën karakteristike të Bankës, shoqëruar me mobilim funksional estetik dhe me skenografi arkitektonike muzeore. Në kuadër të intensifikimit të punës operacionale në lidhje me emetimin e parasë, Banka sapo finalizoi me sukses ndërtesën e re për administrimin dhe ruajtjen e monedhave. Kjo është një qendër moderne që përfshin të gjithë aspektet operacionale të administrimit dhe përpunimit të monedhës në një pikë të vetme, duke rritur kështu eficiencën e Bankës ne këtë drejtim. Gjithashtu, do të vazhdojë zbatimi i projekteve për modernizim e proceseve të cash- it, duke u shtrirë deri në 5 degët të Bankës.

Investimet në objektet e mësipërme do të rrisin funksionalitetin e mjediseve për kryerjen e veprimtarive të Bankës, duke qenë një kontribut i jashtëzakonshëm në ruajtjen dhe evidentimin e trashëgimisë kulturore të qytetit të Tiranës. Këto ndërtesa do të mishërojnë arkitekturën moderne dhe normativat evropiane të fushës, duke reflektuar edhe kontributin konkret të Bankës në ruajtjen dhe promovimin e vlerave arkitekturore shqiptare.

POLITIKA MONETARE

Objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është "arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve". Ky institucion ka si detyrë kryesore "të hartojë, të miratojë dhe të zbatojë në mënyrë të pavarur politikën monetare të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me objektivin e saj kryesor".

Për periudhën 2013-2015, politika monetare e Bankës së Shqipërisë do të vazhdojë të orientohet drejt përmbushjes së këtij objektivi në afat të mesëm, duke synuar njëkohësisht minimizimin e kostove të veprimit të saj mbi sektorin real dhe në atë financiar të ekonomisë. Banka e Shqipërisë synon të përmirësojë vendimmarrjen e saj të politikës monetare, në interes të rritjes së efektivitetit të saj dhe në përgjigje të rritjes së sfidave që vijnë nga zhvillimet e ekonomisë së brendshme dhe të asaj botërore. Ky përmirësim do të realizohet nëpërmjet rritjes cilësore të instrumenteve të analizës dhe të parashikimit, si dhe nëpërmjet forcimit të koordinimit të politikës monetare me atë fiskale dhe me masat makroprudenciale.

REZULTATI I DËSHIRUAR

Nëpërmjet garantimit të stabilitetit të çmimeve, si dhe ankorimit të pritjeve për inflacionin rreth objektivit të saj, Banka e Shqipërisë kontribuon në rritjen e qëndrueshme ekonomike të vendit nëpërmjet ruajtjes së ekuilibrave makroekonomikë, uljes së primeve të rrezikut, përmirësimit të vendimmarrjes së agjentëve të tregut, si dhe mbështetjes së stabilitetit të sistemit financiar.

OBJEKTIVI

Në terma sasiorë, me stabilitet çmimesh Banka e Shqipërisë kupton ruajtjen e inflacionit në nivelin 3.0 %, me një mundësi luhatjeje prej ± 1 pikë përqindjeje rreth kësaj vlere qendrore. Objektivi i inflacionit do të vazhdojë të jetë ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit, i matur dhe i publikuar nga Instituti i Statistikave (INSTAT).

Duke vlerësuar regjimin e inflacionit të shënjestruar si një alternativë optimale të hartimit, zbatimit dhe komunikimit të politikës monetare, Banka e Shqipërisë do të punojë intensivisht për adoptimin e plotë të elementeve të këtij regjimi, duke synuar në një kohë të arsyeshme implementimin formal të tij.

Për periudhën që mbulon kjo strategji, treguesi kryesor i balancës së presioneve inflacioniste në ekonomi do të jetë niveli i inflacionit të parashikuar në një horizont afatmesëm dhe devijimi i tij nga niveli i synuar. Në rastin e devijimeve të mëdha e të qëndrueshme të inflacionit të parashikuar nga niveli i synuar i tij, duke gjykuar dhe mbi shkaqet që çojnë në këto devijime, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendos mbi kahun e politikës monetare. Kjo do të marrë gjithashtu në konsideratë edhe balancën e rreziqeve që shoqërojnë këto projeksione dhe vendimmarrje. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë do të përdorë agregatin monetar të parasë së gjerë (M3) si indikator plotësues për vlerësimin e presioneve inflacioniste në ekonomi. Roli informativ i parasë së gjerë, mbështetet në argumentin se inflacioni është një dukuri monetare në periudha afatgjata dhe, si i tillë, ndikohet nga rritja e masës monetare në ekonomi.

KURSI I KËMBIMIT

Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të zbatojë një regjim të lirë të kursit të këmbimit. Vlera e kursit të këmbimit do të përcaktohet lirisht nga ndërveprimi i kërkesës dhe ofertës për valutë, në përputhje edhe me faktorët themelorë që i përcaktojnë ato.

Në mbështetje të politikës së saj monetare, si një garanci për përballimin e goditjeve të rënda në sektorin real të ekonomisë si dhe në mbështetje të qëndrueshmërisë financiare të vendit, Banka e Shqipërisë angazhohet për mbajtjen e një niveli të mjaftueshëm të rezervave valutore. Duke ndjekur praktikat më të mira botërore, Banka e Shqipërisë do të gjykojë nivelin e mjaftueshmërisë së rezervave, duke u bazuar në respektimin e njëkohshëm të dy kritereve sasiore:

- ruajtjen në afat të mesëm të një niveli rezervash valutore të mjaftueshme për të përballuar të paktën 4 muaj importe mallrash e shërbimesh; dhe
- ruajtjen në afat të mesëm të një niveli rezervash valutore të mjaftueshme për të mbuluar borxhin e huaj afatshkurtër të ekonomisë shqiptare.

INSTRUMENTET

Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të mbështetet në instrumentet e tregut për të përmbushur objektivat e saj të politikës monetare, duke konsideruar njëkohësisht ndikimin e masave makroprudenciale mbi mekanizmin e transmetimit.

Instrumenti kryesor që do të përdoret për të përçuar sinjalet e politikës monetare është norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe marrëveshjeve të anasjella të riblerjes, me afat maturimi njëjavor.

Banka e Shqipërisë do të synojë të përmirësojë më tej kuadrin e instrumenteve të saj, duke synuar rritjen e efektivitetit të tyre dhe duke respektuar kuadrin ligjor në fuqi dhe parimin e veprimit indirekt të tyre në sistemin financiar dhe në ekonominë reale.

PRIORITETET

Prioritetet e Bankës së Shqipërisë në drejtim të rritjes së efektivitetit të politikës monetare, do të jenë si më poshtë:

- Përmirësimi sasior dhe cilësor i punës kërkimore në konsolidimin e modeleve analitike dhe parashikuese. Këto studime duhet të udhëheqin vendimmarrjen strategjike të Bankës së Shqipërisë, nëpërmjet rritjes së saktësisë së parashikimeve, nëpërmjet vlerësimit më të plotë të rreziqeve rreth zhvillimeve të ardhshme ekonomike e monetare, si dhe nëpërmjet vlerësimit më të plotë të përshtatshmërisë së instrumenteve që do të përdoren për përmbushjen e objektivave.
- Koordinimi në rritje i politikës monetare me masat makroprudenciale dhe kuadrin mbikëqyrës të sistemit bankar, në fazën e hartimit, vlerësimit të efekteve të ndërsjella dhe zbatimit të tyre. Njohja më e mirë e bashkëveprimit të këtyre dy politikave dhe koordinimi në rritje i tyre do t'i shërbejë përmirësimit të efektivitetit të ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregjet financiare dhe ekonominë reale.
- Njohja më e plotë e kanaleve të mekanizmit të transmetimit dhe kohëvonesave të politikës monetare, të cilat janë në ndryshim të vazhdueshëm për shkak të zhvillimeve të brendshme të ekonomisë shqiptare dhe kontekstit të krizës globale financiare.
- Rritja e harmonizimit të politikës monetare me atë fiskale, nëpërmjet shkëmbimit të vazhdueshëm të informacionit dhe të analizave e projeksioneve ekonomike, si dhe shkëmbimit të opinioneve mbi ndikimet e ndërsjella të politikave monetare e fiskale.
- Zgjerimi i mëtejshëm i bazës së informacionit të përdorur në vendimmarrje.
- Përmirësimi i funksionimit të tregjeve financiare. Përpjekjet e Bankës së Shqipërisë do të vijojnë të fokusohen në përmirësimin e infrastrukturës së tregut të parasë dhe atij të letrave me vlerë, për të përmirësuar procesin e transmetimit të politikës monetare dhe për t'i shërbyer më mirë operatorëve të tregut. Në këtë drejtim, Banka e Shqipërisë do të punojë për vënien në zbatim të projektit të depozituesit qendror, duke synuar kështu të minimizojë rrezikun e pjesëmarrësve në realizimin e shlyerjes së njëkohshme dhe duke nxitur rritjen e numrit të veprimeve. Gjithashtu, duke synuar nxitjen e aktivitetit të tregut të parasë, Banka e Shqipërisë do të punojë në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës nëpërmjet krijimit të një platforme elektronike tregtimi.

- Zgjerimi dhe përmirësimi i cilësisë së komunikimit të bankës me publikun. Këtu do të synohet veçanërisht një komunikim i qartë, i hapur dhe në kohë i arsyeve të vendimeve të politikës monetare, me një bashkësi sa më të gjerë të grupeve të interesit.
- Zhvillimi i një dialogu të vazhdueshëm me publikun me qëllim thellimin e njohurive mbi politikën monetare; ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë e ruajtjes së stabilitetit të çmimeve dhe formimin e një konsensusi sa më të gjerë social për objektivin e inflacionit të Bankës së Shqipërisë.

VLERËSIMI I PERFORMANCËS

Vlerësimi i performancës së Bankës së Shqipërisë në drejtim të suksesit të saj në sferën e politikës monetare, do të bëhet nëpërmjet shkallës së arritjes së:

- Përmbushjes së objektivit të inflacionit, të matur nga ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit.
- Ankorimit të pritjeve të publikut për inflacionin rreth objektivit të Bankës së Shqipërisë dhe reduktimit të primeve të rrezikut mbi monedhën tonë kombëtare.
- Ankorimit të normave afatshkurtra të interesit në tregun ndërbankar pranë normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë (normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes / të anasjella të riblerjes me afat maturimi njëjavor).
- Vlerësimit të efektivitetit dhe cilësisë së analizave dhe punës kërkimore.

STABILITETI FINANCIAR

Stabiliteti financiar është kusht themelor për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit. Banka e Shqipërisë, në rolin e saj si rregulluese dhe mbikëqyrëse e sektorit bankar, dhe si zhvilluese e sistemeve të pagesave dhe të shlyerjeve, jep një kontribut të drejtpërdrejtë thelbësor në ruajtjen e qëndrueshmërisë së sistemit financiar dhe në zhvillimin e tregut financiar. Kriza e fundit ndërkombëtare financiare, tregoi se mbështetja vetëm në rregullimin financiar, mikroprudencial, neglizhon një dimension të rëndësishëm të stabilitetit financiar siç është ndikimi i dyanshëm mes ecurisë makroekonomike dhe qëndrueshmërisë së institucioneve financiare. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë do të vendosë objektivin për zhvillimin e politikave të përshtatshme makroprudenciale në qendër të veprimtarisë së saj dhe të bashkëpunimit ndërinstitucional.

Zhvillimi i politikave të përshtatshme makroprudenciale, lidhet me identifikimin dhe zbatimin e masave kryesisht prudenciale për parandalimin, kufizimin dhe trajtimin e rreziqeve financiare sistemike. Brenda Bankës së Shqipërisë, kuadri i politikave makroprudenciale do të mbështetet mbi parimet e konsoliduara të pavarësisë institucionale dhe ruajtjes së objektivit parësor të kontrollit mbi normën vjetore të inflacionit. E udhëhequr nga këto parime, Banka e Shqipërisë njëherazi do të nxisë diskutimin dhe vendimmarrjen për veprime të natyrës makroprudenciale që gjejnë mbështetje tek instrumentet e konsoliduara të politikës monetare. Në nivel ndërinstitucional, politikat makroprudenciale efektive kërkojnë vendosjen e një kuadri institucional të përshtatshëm ku përgjegjësitë, përgjegjshmëria dhe mënyra e harmonizimit të veprimeve mes autoriteteve publike të përfshira, janë të mirë-përcaktuara. Këto politika kërkojnë gjithashtu zhvillimin e instrumenteve specifike që vlerësojnë mundësitë e zhvillimit të rreziqeve sistemike përgjatë kohës dhe shtrirjes së tyre ndërsektoriale, si edhe mundësojnë trajtimin e tyre. Në këtë kuadër, Banka, edhe në të ardhmen, do të nxisë diskutimin përfundimtar të këtyre çështjeve në takimet periodike të Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar.

Zhvillimi i kuadrit të politikave makroprudenciale, do të mbështetet në komunikimin sistematik mes departamenteve të Bankës dhe të komiteteve të ndryshme brenda saj. Banka do të jetë pjesë aktive e këtij diskutimi dhe do t'i mbështesë ato nëpërmjet analizave të zhvillimeve makroekonomike dhe financiare, vlerësimeve për ecurinë e rreziqeve të ndryshme, propozimeve për veprime të natyrës makroprudenciale dhe ndjekjes së zbatimit të tyre. Si edhe më parë, Banka do të përdorë Raportin e Stabilitetit Financiar dhe Deklaratën e Stabilitetit Financiar, për të paraqitur tek publiku vlerësimin e saj lidhur me qëndrueshmërinë e sistemit financiar.

Në mënyrë më konkrete, gjatë periudhës 2013-2015, puna në drejtim të stabilitetit financiar do të përqendrohet për realizimin e këtyre objektivave:

- plotësimi i kuadrit të treguesve që vlerësojnë ecurinë e rrezikut sistemik në sistemin financiar, dhe adoptimi i një procedure për vlerësimin periodik të përshtatshmërisë së tyre – brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2013;
- zhvillimi i teknikave të ndryshme që provojnë rezistencën e sektorit bankar dhe të sistemit financiar, ndaj skenarëve të ndryshëm makrofinanciare dhe ekspozimit ndaj rrezikut të kreditit, të tregut, dhe të likuiditetit – në vazhdimësi;
- përmirësimi i kuadrit të administrimit të situatave të jashtëzakonshme financiare, në nivel institucional dhe ndërinstitucional, nëpërmjet identifikimit të përmirësimeve të ndryshme rregullative dhe operacionale – në vazhdimësi;
- zhvillimi i një treguesi/indeksi që vlerëson ecurinë e pasurive të paluajtshme (të shtëpive) – brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2013;
- ndërtimi i një modeli që vlerëson ndikimin e ndërsjellët mes performancës së sektorit bankar dhe ecurisë së treguesve makroekonomikë, duke mundësuar përmirësimin e aftësive parashikuese të Bankës së Shqipërisë – brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2013;
- identifikimi i politikave makroprudenciale kundërciklike, të cilat mundësojnë uljen e varësisë së performancës së sistemit financiar, dhe posaçërisht të atij bankar, ndaj luhatjeve në ciklin ekonomik – brenda vitit 2013;
- zhvillimi i analizës për mundësinë e trajtimit të "veçantë" të bankave dhe të institucioneve financiare me rëndësi sistemike, duke përfshirë edhe vendosjen e kërkesave më të larta për kapitalizimin dhe likuiditetin e veprimtarisë së tyre – brenda vitit 2013;
- zhvillimi i analizës për të vlerësuar nevojën e përmirësimit te kuadrit institucional që lidhet me mbrojtjen e konsumatorit të shërbimeve financiare – brenda vitit 2014;
- rritja e transparencës për vlerësimet dhe analizat mbi qëndrueshmërinë e sistemit financiar, nëpërmjet komunikimit të tyre tek industria financiare dhe rishikimit të përmbajtjes së publikimeve periodike dhe të posaçme – në vazhdimësi.

Realizimi i objektivave të mësipërm përfaqëson një sfidë për personelin e Bankës, e cila do të përballohet me profesionalizëm dhe përkushtim. Zhvillimi profesional i personelit përfaqëson një objektiv të vazhdueshëm. Gjatë periudhës që mbulon kjo strategji, Banka do të bëjë një vlerësim të përshtatshmërisë së përbërjes së strukturave përgjegjëse për stabilitetin financiar dhe, nëse del e nevojshme, gjatë periudhës 2013-2015, do të identifikojë propozimet përkatëse në lidhje me:

- ndryshimet rregullative për të mundësuar: (i) specializimin më të ngushtë të personelit; (ii) rritjen e numrit të personelit; dhe
- kryerjen e trajnimeve në drejtime të caktuara.

MBIKËQYRJA BANKARE

Gjatë periudhës 2013-2015, Banka e Shqipërisë do të mbështetet në rezultatet pozitive të arritura deri tani në implementimin e Strategjisë Afatmesme të Mbikëqyrjes Bankare (2009-2014), duke e shfrytëzuar përvojën e përftuar për të kalibruar më tej burimet e veta organizative në drejtim të forcimit të mëtejshëm të mbikëqyrjes së bazuar në rrezik. Objektivi themelor në këtë drejtim do të vijojë të mbetet sigurimi i veprimtarisë bankare të shëndetshme në vend, e cila garanton sigurinë e kursimeve të qytetarëve shqiptarë, mbështet stabilitetin financiar dhe kontribuon në ecurinë pozitive të ekonomisë në tërësi.

Në funksion të këtij objektivi, Banka e Shqipërisë do të mbështetet në këto shtylla kryesore:

- ZHVILLIMI I METODOLOGJISË

Zhvillimi i metodologjisë do të synojë strukturimin e mëtejshëm të procedurave mbikëqyrëse duke identifikuar në vijimësi përmirësimet e nevojshme mbështetur në standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira. Në këtë kuadër, do të jetë i rëndësishëm rishikimi dhe pasurimi i mëtejshëm i procedurave mbikëqyrëse, dhe analizës së rreziqeve në përputhje me nivelin e sofistikimit në rritje të veprimtarisë bankare në vend, duke siguruar bazën për identifikimin dhe vlerësimin e çdo rreziku material.

Do të nxitet përdorimi i sistemeve efektive të administrimit të rrezikut dhe planifikimit të nevojave për kapital nga bankat si komponentë shumë të rëndësishëm të vlerësimit mbikëqyrës në kuadrin e Shtyllës II të Baselit.

- ZHVILLIMI I KUADRIT RREGULLATOR

Zhvillimi i kuadrit rregullator do të vijojë i orientuar nga objektivi themelor i përafrimit me Basel II dhe Direktivat e Bashkimit Evropian (BE), njëkohësisht duke shfrytëzuar gjithë hapësirat e mundshme për të ruajtur fleksibilitetin dhe përshtatur aktet rregullative, në përputhje me zhvillimet në sistemin bankar në vend.

Adoptimi i rregullores së re mbi mjaftueshmërinë e kapitalit si një nga projektet madhore në kuadrin e harmonizimit me standardet e BE. Për nga vetë rëndësia e rregullores, hyrja në fuqi e saj synohet të paraprihet nga një proces diskutimi i gjerë me industrinë bankare.

Adoptimi i standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit (IFRS) në raportimin për qëllime rregullatore përbën një komponent tjetër të domosdoshëm drejt adoptimit të plotë të kornizës së Basel II.

Në kushtet e krijuara pas krizës financiare kur standardet rregullatore dhe mbikëqyrëse në nivel ndërkombëtar kanë hyrë në një fazë ndryshimesh të rëndësishme në kuadrin e reformës financiare globale, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të reflektojë në kuadrin rregullator vendas të gjitha elementet relevante për sistemin bankar shqiptar.

- **ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE**

Zhvillimi i burimeve njerëzore do të përqendrohet në intensifikimin e trajnimit të stafit në përputhje me rritjen e nivelit të sofistikimit të bazës rregullatore dhe metodologjike në dispozicion, të cilat nga njëra anë krijojnë hapësira më të gjera në ushtrimin e kompetencave mbikëqyrëse, ndërkohë që prezantojnë edhe sfida në drejtim të nevojës për rritjen e kapaciteteve administrative dhe profesionale për një shfrytëzim të plotë dhe efektiv të tyre. Në këtë kuadër, me rëndësi të veçantë do të jetë thellimi i njohurive lidhur me kuadrin e ri rregullativ e mbikëqyrës në linjë me Basel II, Direktivat e BE si dhe standardet më të mira ndërkombëtare.

- **FORCIMI I BASHKËRENDIMIT TË MBIKËQYRJES BANKARE, STABILITETIT FINANCIAR DHE POLITIKËS MONETARE**

Bashkërendimi i mbikëqyrjes bankare me stabilitetin financiar synon harmonizimin efektiv të qasjes mikroprudenciale me atë makroprudenciale, duke përfituar nga sinergjia që mundëson koordinimi i instrumenteve përkatëse. Ky bashkëpunim do të synojë veçanërisht mbështetjen e veprimtarisë mbikëqyrëse dhe rregullative të Bankës së Shqipërisë me kuadrin e domosdoshëm analitik për të mundësuar aplikimin e politikave makroprudenciale në funksion të objektivit themelor të ruajtjes së stabilitetit financiar të vendit.

Tërësia e instrumenteve mikroprudenciale do të vijojë të kontribuojë në rritjen e efektivitetit të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë.

Veprimtaria e mbikëqyrjes bankare do të integrojë të gjitha sinjalet relevante që burojnë nga politika monetare dhe stabiliteti financiar, për të mbështetur analizën e rreziqeve me të cilat përballet sistemi bankar dhe bankat e veçanta, duke i vendosur ato në kontekstin e duhur makroekonomik.

- **FORCIMI I BASHKËPUNIMIT ME AUTORITETET MBIKËQYRËSE TË HUAJA**

Bashkëpunimi me autoritetet mbikëqyrëse të huaja do të vazhdojë të mbështetet në formalizimin e marrëdhënieve nëpërmjet plotësimit të kuadrit të marrëveshjeve përkatëse me të gjitha autoritetet homologe relevante (MoU).

Këto marrëveshje shërbejnë për të zgjeruar bashkëpunimin edhe me autoritetet me të cilat Banka e Shqipërisë ende nuk ka formalizuar bashkëpunimin. Ndërkohë, do të vazhdojë thellimi i bashkëpunimit me institucionet mbikëqyrëse të huaja nëpërmjet shkëmbimit të informacionit dhe bashkërendimit të veprimtarive përmes pjesëmarrjes në kolegjet mbikëqyrëse dhe mbajtjes së kontakteve intensive në vazhdimësi.

- **FORCIMI I DIALOGUT DHE BASHKËPUNIMIT ME INDUSTRINË BANKARE**

Dialogu me industrinë bankare do të përqendrohet në nxitjen e pjesëmarrjes dhe kontributit të vetë industrisë bankare në iniciativat që, nga njëra anë rrisin përgjegjshmërinë dhe administrimin e shëndetshëm të veprimtarisë bankare dhe nga ana tjetër, nëpërmjet një bashkëpunimi për çështje të mirëkuptuara dhe dakorduara të mund të merren përfitime të përbashkëta.

- **RRITJA E TRANSPARENCËS DHE E MBROJTJES SË KLIENTIT**

Në kuadrin e rritjes së transparencës dhe mbrojtjes së klientit, Banka e Shqipërisë do t'i kushtojë një rëndësi të veçantë nxitjes së politikave mbi përcaktimin e kushteve të qarta të ofrimit të produkteve dhe shërbimeve bankare dhe transparencës lidhur me to.Një dimension i rëndësishëm do të jetë edhe ndërgjegjësimi i publikut për instrumentet e disponueshme dhe mundësitë e përdorimit të tyre në mënyrë efikase për të ushtruar kështu rolin e domosdoshëm në përftimin e produktit të synuar, përmes një konkurrence të shëndetshme.

- **SISTEMI I RAPORTIMIT TË TË DHËNAVE DHE CILËSIA E TYRE**

Rritja e mëtejshme e cilësisë së statistikave dhe analizave të prodhuara nga Banka e Shqipërisë do të mbështetet në sistemin e përmirësuar të raportimit të të dhënave i cili është duke u zhvilluar me kontributin e Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Investimi në këtë sistem do të përbëjë një bazë të rëndësishme si në drejtim të mundësimit të analizave më të gjera, të thella dhe më eficiente, ashtu edhe në kuadrin e implementimit të harmonizuar të standardeve të reja raportuese sipas IFRS.

Banka e Shqipërisë me synim nxitjen e sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit kombëtar të pagesave në Shqipëri, në periudhën afatmesme, do të intensifikojë përpjekjet e saj në kuadër të fuqizimit të rolit të saj mbikëqyrës, përmirësimit të infrastrukturës me qëllim shtrirjen gjithnjë e më të madhe të përdorimit të tyre nga publiku, si edhe një roli më aktiv si nxitës dhe promotor i reformave në fushën e sistemit të pagesave në përgjigje të nevojave dhe kushteve aktuale të tregut. Synimet e lartpërmendura, vlerësohet të mbështeten gjithashtu edhe nga rritja e transparencës me qëllim familjarizimin e publikut me funksionimin e sistemit të pagesave dhe rritjen e sensibilizimit të tyre nga ndryshimet në këtë fushë.

Bazuar në këto boshte, objektivat kryesorë të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2013-2015 konsistojnë në:

Përmirësimi dhe plotësimi i infrastrukturës së tregjeve financiare.

- Ky objektiv do të realizohet kryesisht me ndërtimin e regjistrit qendror të titujve (CSD) dhe integrimin e tij me sistemet aktuale të shlyerjes (AIPS) dhe klerimit (AECH), të cilat operohen nga Banka e Shqipërisë.

Fuqizimin e rolit mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në sistemin e pagesave nëpërmjet ridimensionimit të tij në një rol më aktiv dhe të kujdesshëm, sipas praktikave më të mira ndërkombëtare dhe në veçanti atyre evropiane pas krizës financiare globale. Objektivi i lartpërmendur pritet të materializohet nëpërmjet:

- Përmirësimit dhe plotësimit të bazës ligjore dhe rregullative.
- Nxitjes e bashkëpunimit ndërdepartamental dhe ndërinstitucional me qëllim kryerjen me efikasitet të mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave dhe shmangien e mbivendosjes së veprimeve.
- Përmirësimit të mëtejshëm të kapaciteteve institucionale në kuadër të implementimit me efikasitet të rregullave dhe proceduarave të krijuara nga përmirësimi dhe plotësimi i kuadrit ligjor.
- Përmirësimit të vlerësimeve për infrastrukturën e tregjeve financiare kundrejt parimeve themelore (parimet e BIS Basel), mbi bazën e vlerësimeve të deritanishme.

Përmirësimin e infrastrukturës si nga ana teknike ashtu edhe nga ana rregullative, me qëllim përafrimin me praktikat më të mira evropiane dhe njëkohësisht rritjen

e sigurisë dhe eficiencës me synim promovimin e masës së përdorimit të sistemit nga publiku. Ky objektiv synohet të realizohet nëpërmjet:

- Përmirësimit të sistemeve aktuale të pagesave që operohen nga Banka e Shqipërisë dhe ndërfaqësimit të tyre me sisteme të tjera.
- Intensifikimit të aktivitetit studimor në lidhje me instrumentet e pagesave, me qëllim analizimin dhe thellimin në problematikat me të cilat përballet tregu shqiptar si dhe adresimin e zgjidhjeve të përshtatshme në natyrën e këtij tregu.

Promovimin e rolit katalizator të Bankës së Shqipërisë nëpërmjet:

- Nxitjes së automatizimit nëpërmjet optimizmit të rrjedhjes së pagesës në sisteme.
- Nxitjes e bashkëpunimit ndërbankar me qëllim krijimin e infrastrukturës së nevojshme dhe përafrimit nga ana rregullative dhe teknike e instrumenteve të pagesave, me rregullat dhe parimet e funksionimit të instrumenteve të pagesave në kuadrin e Zonës së Vetme të Pagesave në Euro (SEPA).
- Riaktivizimit të Komitetit Kombëtar të Pagesave, bazuar në rregulla dhe procedura moderne të përshtatura në nevojat aktuale të tregut.
- Marrjes së masave për përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese si dhe krijimin e infrastrukturave të reja, të cilat do t'i vijnë në ndihmë prezantimit dhe përdorimit të pagesave novatore.
- Nxitjes së përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave, si rrjedhojë reduktimit të parasë fizike në ekonomi, kryesisht nëpërmjet përafrimit të kuadrit ligjor vendas me atë evropian, që lidhen me shërbimet e pagesave dhe paranë elektronike.

Rritjes së transparencës ndaj publikut, nëpërmjet kryerjes së këtyre veprimeve:

- Publikimit të politikave të ndjekura nga ana e Bankës së Shqipërisë në lidhje me mbikëqyrjen e të gjithë komponentëve të rëndësishëm në sistemin e pagesave, duke përcaktuar qartazi metodat dhe instrumentet e përdoruara nga ana e saj për këtë qëllim.
- Publikimit të raporteve mbi vlerësimin e sistemeve në përputhje me parimet ndërkombëtare për infrastrukturën e tregjeve financiare.
- Përpunimit dhe publikimit periodik të të dhënave për treguesit e instrumenteve dhe të sistemeve të pagesave.

Objektivat e Bankës së Shqipërisë përfshijnë përmirësimin e kuadrit rregullator mbi të cilin mbështetet qarkullimi dhe kontrolli për autenticitetin e parasë, përmirësimin e cilësisë së kartëmonedhave në qarkullim, rritjen e efektivitetit dhe kapacitetit në veprimtarinë përpunuese që Banka zhvillon, rritjen e angazhimit për mbrojtjen nga falsifikimi, studimin e vazhdueshëm të strukturës së parasë në qarkullim, si dhe zhvillimin e aktivitetit numizmatik.

- **PËRMIRËSIMI I KUADRIT RREGULLATOR**

Banka e Shqipërisë do të rishikojë rregullat dhe kriteret e përdorura për përpunimin e kartëmonedhave me qëllim vendosjen e standardeve të unifikuara për qarkullimin e parasë në sistemin bankar shqiptar. Rishikimi i kuadrit rregullativ për administrimin dhe përpunimin e kartëmonedhave dhe monedhave metalike shqiptare do të realizohet duke marrë në konsiderate standardet bashkëkohore të vendosura dhe të zbatuara nga Bashkimi Evropian dhe Banka Qendrore Evropiane, në lidhje me qarkullimin e parasë.

- **PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË KARTËMONEDHAVE NË QARKULLIM**

Banka e Shqipërisë synon që cilësia e kartëmonedhave në qarkullim të jetë e mirë dhe e pranueshme, me qëllim rritjen e besueshmërisë të publikut dhe mbrojtjen e integritetit të kartëmonedhave. Gjatë vitit 2013 do të vendoset standardi për hedhjen në qarkullim nëpërmjet ATM-ve, vetëm të kartëmonedhave të përpunuara me makina automatike sortimi, të cilat kaluan me sukses testimin e Bankës së Shqipërisë. Në këtë mënyrë, do të sigurohet një rikthim i vazhdueshëm i kartëmonedhave në Bankën e Shqipërisë dhe do të mundësohet rritja e kontrollit të cilësisë së atyre në qarkullim.

- **PËRMIRËSIMI I EFEKTIVITETIT NË PËRPUNIM**

Banka e Shqipërisë synon të zbatojë procese të automatizuara të përpunimit, paketimit dhe shkatërrimit të kartëmonedhave, në qendrën e re të cash-it. Investimet në makinat automatike të përpunimit të kartëmonedhave do të shoqërohen nga instalimi i një impianti për shkatërrimin dhe briketimin e kartëmonedhave të papërshtatshme për riqarkullim, si dhe instalimi i një sistemi

profesional paketimi në vakum. Gjithashtu, synohet zëvendësimi i sistemit aktual informatik të administrimit të cash-it me një program të ri bashkëkohor.

Banka e Shqipërisë do të konsiderojë rritjen graduale të kapaciteteve përpunuese të saj, për të siguruar mbulimin e plotë të nevojave të tregut me kartëmonedhë të përpunuar me makina sortimi. Në të ardhmen, do të inkurajohet vendosja e kapaciteteve përpunuese dhe në bankat tregtare.

- ## MBROJTJA NDAJ FALSIFIKIMIT

Banka e Shqipërisë, nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Analizës, do të rikonceptojë përqasjen ndaj falsifikimit të parasë, duke filluar nga aspektet rregullatore, administrative, laboratorike dhe deri tek edukimi i publikut. Ky do të jetë standardi i ri që Banka e Shqipërisë do të ndjekë dhe në të njëjtën kohë do të përmbushet një nga kërkesat e acquis communautaire (mbrojtja e parasë nga falsifikimi) për hyrjen e vendit në BE.

- ## STUDIMI I STRUKTURËS SË PARASË NË QARKULLIM

Banka e Shqipërisë analizon vazhdimisht strukturën e parasë në qarkullim. Një strukturë e përshtatshme e prerjeve bën të mundur lehtësimin dhe optimizimin e transaksioneve të pagesave. Rezultat i kësaj kësaj analize ishte dhe shtimi i prerjes 2000 Lekë dhe hedhjes së saj në qarkullim në vitin 2008. Objekt i studimit të strukturës do të jetë numri i prerjeve për kartëmonedhat dhe monedhat metalike, kufiri i prerjes së sipërme të kartëmonedhës, si dhe kufiri ndërmjet monedhës metalike dhe kartëmonedhës.

- ## RRITJE E AKTIVITETIT NUMIZMATIK

Banka e Shqipërisë do të rrisë aktivitetin e saj numizmatik. Aktiviteti numizmatik shihet si një metodë efektive për të realizuar prezantimin, promovimin dhe njohjen me kulturën, historinë dhe vlerat kombëtare të një vendi. Veprimtaria numizmatike do të synojë të forcojë urat e komunikimit jo vetëm me publikun shqiptar por edhe atë të huaj. Për të realizuar këtë, Banka e Shqipërisë do të organizojë ekspozita të ndryshme, do të publikojë katalogë të parasë shqiptare ndër vite, si dhe do të vijojë me prodhimin e monedhave numizmatike.

STATISTIKAT

Banka e Shqipërisë në shërbim të hartimit dhe zbatimit të politikës monetare prodhon dhe publikon statistika zyrtare për sektorin monetar dhe sektorin e jashtëm të ekonomisë. Këto statistika përfaqësojnë një bazë të rëndësishme informacioni për politikat dhe vendimmarrjen ekonomike dhe financiare të shtetit dhe të agjentëve ekonomikë. Banka e Shqipërisë bën pjesë në sistemin statistikor kombëtar dhe zbaton legjislacionin, që rregullon funksionimin dhe bashkëpunimin e agjencive statistikore të këtij sistemi. Puna e saj si agjenci statistikore në periudhën afatmesme do të orientohet drejt plotësimit të detyrave dhe hartimit të treguesve të përcaktuar në Programin e Statistikave Zyrtare 2012-2014.

Objektivat afatgjatë të Bankës së Shqipërisë në fushën e statistikave shtrihen në dy drejtime kryesore:

- Përqasjen me standardet e Bashkimit Evropian, veçanërisht përafrimin e legjislacionit, të metodologjive dhe të produkteve statistikore me aktet e Komisionit Evropian, Bankës Qendrore Evropiane dhe Eurostat-it.
- Përmirësimi i shërbimit statistikor për publikun, që përfshin zgjerimin e bazës së treguesve statistikorë, rritjen e nivelit të detajimit dhe të shkallës së mbulimit të treguesve. Banka e Shqipërisë do të vijojë të investojë në mjetet e komunikimit dhe shpërndarjes së informacionit në publik, duke punuar paralelisht për rritjen e shkallës së edukimit, njohjes dhe përdorimit të saktë të treguesve statistikorë.

Objektivat afatmesëm të Bankës së Shqipërisë në fushën e statistikave janë:

- Përmirësimi i infrastrukturës teknologjike me qëllim rritjen e eficiencës së raportimit, uljen e ngarkesës së raportimit dhe rritjen e cilësisë së statistikave. Në këtë kuadër ka filluar puna për vendosjen e një sistemi të automatizuar raportimi të financuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Ky projekt parashikon rishikimin e bazës rregullative, rishikimin dhe harmonizimin e formave të raportimit dhe trajnimin e subjekteve raportuese. Platforma e re e raportimit, që do të vihet në përdorim brenda periudhës 2013-2015, do të kontribuojë në përmirësimin e konsiderueshëm si të treguesve të nevojshëm për mbikëqyrjen bankare dhe analizat e stabilitetit financiar, ashtu edhe në atë të statistikave zyrtare të Bankës së Shqipërisë.
- Bashkërendimi i kërkesave për raportimin e bankave të nivelit të dytë për qëllime statistikore dhe nevoja të mbikëqyrjes, me qëllim minimizimin e ngarkesës së subjekteve raportuese.

STATISTIKAT E SEKTORIT MONETAR

- Zgjerimi i mbulimit përtej sektorit bankar, duke përfshirë në prodhimin e rregullt statistikor edhe institucionet financiare jo-banka.
- Prodhimi i treguesve të rinj statistikorë, në përputhje me kërkesat dhe standardet e raportimit të agjencive statistikore të Komunitetit Evropian, si Banka Qendrore Evropiane dhe Eurostat.

STATISTIKAT E LLOGARIVE FINANCIARE

- Prodhimi i statistikave të llogarive financiare për sektorin financiar dhe ngritja e strukturës përkatëse ndërinstitucionale, hartimi i metodologjisë dhe identifikimi i burimeve në funksion të prodhimit të llogarive financiare për të gjithë sektorët e ekonomisë.

STATISTIKAT E SEKTORIT TË JASHTËM

- Në horizontin afatmesëm objektivi kryesor është përshtatja e statistikave të bilancit të pagesave dhe të pozicionit të investimeve ndërkombëtare me standardet dhe kërkesat e 'Manualit të Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare', Edicioni 6, FMN 2010 dhe ato të manualit 'Përkufizimi i kufirit të investimeve të huaja', Edicioni 4, OECD 2008.
- Një objektiv tjetër i rëndësishëm është plotësimi i kërkesave të Eurostat-it sipas Vademecum 2011 dhe kërkesave të Bankës Qendrore Evropiane mbi detajimin e statistikave të bilancit të pagesave sipas shteteve dhe sektorëve ekonomikë.

Aktivitetet nëpërmjet të cilave do të arrihen objektivat afatmesëm janë:

- Hartimi i akteve nënligjore përfshirë rregullore, manuale, forma raportimi dhe udhëzues për të përmirësuar prodhimin statistikor në përputhje me manualet metodologjike ndërkombëtare.
- Përmirësimi i strukturës organizative në përshtatje me kërkesat e reja të prodhimit, shpërndarjes dhe raportimit statistikor pranë organizmave të Bashkimit Evropian.
- Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore nëpërmjet pjesëmarrjes në seminare, kurse trajnimi të ofruara nga institucione kombëtare e ndërkombëtare dhe vizita pune në institucione homologe.
- Përforcimi i kapaciteteve teknologjike nëpërmjet investimit në trajnime dhe në programe bashkëkohore për menaxhimin e të dhënave statistikore.
- Forcimi i bashkëpunimit midis agjencive statistikore dhe përdoruesve të

statistikave zyrtare nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe të bashkëpunimit, aktiviteteve dhe projekteve të fokusuara në sektorë të veçantë të statistikave.

STATISTIKAT E SEKTORIT MONETAR

- Përgatitja e manualeve dhe përshtatja e statistikave monetare e financiare në përputhje me kërkesat për raportim të Bankës Qendrore Evropiane dhe adoptimi i standardeve të rishikuara statistikore SNA/ESA.
- Përmirësimi i kapaciteteve teknologjike nëpërmjet automatizimit të infrastrukturës së mbledhjes, kontrollit, vlerësimit e hartimit të statistikave monetare e financiare.

STATISTIKAT E SEKTORIT TË JASHTËM

- Hartimi i planit afatmesëm për përmirësimet metodologjike të statistikave të bilancit të pagesave, në përputhje me standardet statistikore ndërkombëtare.
- Përshtatja e formave të raportimit të të dhënave për nevoja statistikore sipas Manualit të Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të investimeve ndërkombëtare, Edicioni 6, FMN 2010 dhe Vademecum, Eurostat 2011.
- Shtim të numrit të vrojtime statistikore tremujore dhe vjetore me qëllim sigurimin e të dhënave të detajuara për investimet direkte, shërbimet e udhëtimit dhe dërgesave nga emigrantët.

REZULTATE TË PRITSHME

STATISTIKAT E SEKTORIT MONETAR

- Ngritja e modelit pilot dhe dokumenteve metodologjike për ndërtimin e llogarisë financiare të institucioneve monetare financiare dhe institucioneve të tjera financiare.
- Përgatitja dhe shpërndarja e tabelave statistikore për institucionet financiare jobanka, duke plotësuar spektrin e nënsektorëve të sektorit të korporatave financiare.
- Përgatitja dhe shpërndarja e treguesve të rinj monetarë e financiarë si statistikat e normave të interesit dhe statistikat flukse për depozitat dhe huatë, mbështetur në metodologjitë dhe praktikat ndërkombëtare.

STATISTIKAT E SEKTORIT TË JASHTËM

- Plani afatmesëm i detajuar me aktivitete statistikore dhe me një kalendar

veprimesh në përmbushje të objektivave afatmesme.

- Tregues statistikorë të bilancit të pagesave të detajuar sipas standardeve ndërkombëtare.
- Statistikat tremujore të stokut dhe fluksit të investimeve të huaja direkte, në përputhje me kërkesat e Eurostat-Vademecum 2011.
- Ndërtimi i sistemit për statistikat OFATS, në bashkëpunim me INSTAT sipas kërkesave te Eurostat-Vademecum 2011.

PAVARËSIA DHE QEVERISJA

Në bazë të ligjit të saj organik, Banka e Shqipërisë, brenda kompetencave që i njeh ligji, është e pavarur nga çdo pushtet tjetër për realizimin e objektit kryesor të veprimtarisë së saj dhe në ushtrimin e detyrave të ngarkuara. Megjithatë, Banka e Shqipërisë mbështetet tek Qeveria dhe te Kuvendi për kapitalin themeltar të saj, si dhe zgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës. Në këtë drejtim, ligji organik i Bankës së Shqipërisë dhe aktet nënligjore të Këshillit Mbikëqyrës do të përmirësohen me qëllim forcimin e pavarësisë funksionale, institucionale, financiare dhe personale të institucionit.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

Forcimi i pavarësisë së Bankës së Shqipërisë dhe rritja e bashkëpunimit me organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe institucionet e pavarura.

TREGUESIT

Forcimi i pavarësisë së Bankës së Shqipërisë nënkupton:

- Forcimin e pavarësisë financiare. Ndryshimet do të konsistojnë në pajisjen e Bankës së Shqipërisë me garancitë dhe mjetet financiare të duhura për të përmbushur objektivat e saj. Këto përfshijnë: (i) kërkesën që kapitali i Bankës së Shqipërisë të jetë plotësisht i paguar; (ii) përputhshmërinë me IFRS të skemës së shpërndarjes së fitimeve dhe trajtimit të fitimeve të parealizuara dhe humbjeve; (iii) ndalimin, me disa kufizime, të huadhënies ndaj Qeverisë. Ky proces do të realizohet në disa faza.
- Forcimin e pavarësisë institucionale. Masat në këtë drejtim synojnë konsolidimin e sferës së autonomisë së Bankës së Shqipërisë si dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe punonjësve të saj, kundrejt çdo personi apo entiteti tjetër, duke përfshirë edhe autoritetet shtetërore.
- Forcimin e pavarësisë funksionale. Edhe pse ligji organik i prioritizon objektivat e Bankës së Shqipërisë dhe përcakton stabilitetin e çmimeve si objektivi kryesor, synohet të qartësohet më tej hierarkia e objektivave. Gjithashtu, do të shtohet si objektiv edhe mbështetja e politikave të përgjithshme ekonomike të vendit. Ky objektiv, do të jetë i ndërvarur ndaj

objektivit parësor dhe atij dytësor (nxitja dhe mbajtja e stabilitetit financiar).
- Forcimin e pavarësisë personale. Ka vend të përmirësohen edhe procedurat e emërimit dhe shkarkimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, duke kontribuar kështu në forcimin e llogaridhënies së Bankës së Shqipërisë.
- Gjithashtu, në kuadër të ruajtjes dhe forcimit të pavarësisë së Bankës së Shqipërisë synohet rishikimi i marrëveshjes me Ministrinë e Financave për të siguruar përputhshmërinë e saj me ligjin organik për sa i përket shpërndarjes së fitimit në buxhetin e shtetit. Këto rishikime do të adresojnë rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe audituesit e jashtëm në lidhje me çështjet të cilat janë objekt i rregullimit të kësaj marrëveshje.

Realizimi i objektivave strategjikë në fushën e pavarësisë do të bëhet i mundur nëpërmjet:

- përafrimit ligjor me Traktatin e BE-së dhe Traktatin e funksionimit të BE-së si dhe me Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe Bankës Qendrore Europiane;
- rishikimit të Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave.

Në funksion të përmirësimit të pavarësisë ligjore të Bankës së Shqipërisë, si dhe të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fushën bankare parashikohet asistencë teknike, takime me ekspertë të FMN-së dhe bankave të tjera qendrore, anëtare të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore.

QEVERISJA

Qeverisja e Bankës së Shqipërisë, nga pikëpamja juridike, lidhet me politikat, programet dhe shërbimet e nevojshme për të pasur një qeverisje të mirë dhe një menaxhim efektiv të burimeve për aktivitetet e Bankës.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

Objektivat kryesorë të qeverisjes në Bankën e Shqipërisë janë:

- përsosja e qeverisjes;
- forcimi i bazës ligjore dhe rregullative; dhe
- forcimi i menaxhimit të rrezikut dhe rritja e transparencës së shërbimit ligjor.

TREGUESIT

Treguesit e realizimit të objektivave në fushën e qeverisjes së mirë janë:

- hartimi i politikave legjislative të kujdesshme nga Banka e Shqipërisë;
- mbrojtja e statusit juridik të Bankës së Shqipërisë;
- rritja e eficiencës së shërbimeve dhe programeve që mbështesin objektivat e Bankës së Shqipërisë;
- njohja me kuadrin rregullativ dhe ndërgjegjësimin e stafit të Bankës me shërbimet juridike dhe menaxhimin e vazhdueshëm që i bëhet riskut ligjor.

Në zbatim të objektivave të mësipërm, masat konkrete për t'u marrë nga Banka e Shqipërisë në mënyrë të përmbledhur, mund të kanalizohen në veprimtaritë e mëposhtme:

- ofrimi në mënyrë të specializuar i shërbimeve në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi;
- përfaqësimi i Bankës së Shqipërisë në organet gjyqësore;
- sigurimi dhe përmirësimi i cilësisë të akteve juridike.

Ndikimi i këtyre masave pritet të jetë:

- Përmirësimi i instrumenteve për identifikimin dhe analizimin e rrezikut ligjor;
- Analizimi i kuadrit ligjor ekzistues dhe plotësimi i boshllëqeve ligjore në përshtatje me zhvillimin e sistemit bankar dhe financiar në përgjithësi.
- Zhvillimi i performancës së personelit që ofron shërbimin juridik në Bankën e Shqipërisë

LLOGARIDHËNIA

Sigurimi i "pajtueshmërisë me standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm".

Auditimi i brendshëm është veprimtaria e pavarur, që jep siguri të arsyeshme dhe këshilluese, e ndërtuar për të shtuar vlerën dhe përmirësuar veprimtaritë e organizatës. Ai ndihmon organizatën të përmbushë objektivat e saj, duke zbatuar një metodë sistematike të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e drejtimit të rrezikut, kontrollit dhe proceseve të qeverisjes.

Auditimi i brendshëm për të përmbushur këtë mision drejtohet nga këto parime bazë: (i) integriteti; (ii) pavarësia; (iii) objektiviteti dhe paanshmëria; (iv) konfidencialiteti; dhe (v) kompetenca.

Veprimtaritë kryesore të Bankës së Shqipërisë në fushën e auditimit të brendshëm janë:

- Dhënia e sigurisë së arsyeshme se kontrollet e brendshme të vendosura nga Drejtimi i Bankës funksionojnë në mënyrë të përshtatshme dhe janë efektive.
- Dhënia e sigurisë mbi mbarëvajtjen e zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë.
- Veprimi si një masë kontrolli e përgjithshme dhe shërbim konsulence për Drejtimin dhe Këshillin Mbikëqyrës.

Objektivat kryesorë të Bankës së Shqipërisë në fushën e auditimit të brendshëm janë:

- përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të auditimit të brendshëm dhe atyre këshilluese;
- përmirësimi i procesit të drejtimit të rrezikut.

Synimi strategjik dhe objektivat kryesorë do të përmbushen duke konsoliduar arritjet e deritanishme, si:

- përmirësimi i komunikimit me njësitë e audituara, me Drejtimin dhe Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë;
- përmirësimi i bazës rregullative dhe manualit të procedurave të auditimit të brendshëm;
- përmirësimi i procesit të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së auditit të brendshëm;
- përmirësimi i metodologjisë për vlerësimin e rrezikut të funksioneve/ proceseve të audituara;
- përdorimi i hartave të rreziqeve në orientimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm;
- thellimi i edukimit dhe certifikimit të audituesve të brendshëm.

KOMUNIKIMI

Suksesi i politikës monetare lidhet edhe me rëndësinë që shoqëria i jep stabilitetit monetar; pra sa vëmendje tërheqin çështjet e lidhura me politikën monetare; në çfarë mase e mbështet publiku një bankë qendrore të pavarur dhe sa mirë banka qendrore ia komunikon publikut veprimet e saj. Rrjedhimisht, komunikimi përbën një instrument kyç, jo teknik të politikës monetare.

Në mënyrë që politika monetare të jetë sa më e kuptueshme, Banka e Shqipërisë mbështet komunikimin ndërveprues me publikun si një çështje parësore

dhe me rëndësi strategjike. Një komunikim transparent ndihmon në rritjen e besueshmërisë dhe efektivitetit të politikës monetare, duke bërë që publiku të kuptojë si duhet vendimet e marra nga Këshilli Mbikëqyrës.

Në interes të përmirësimit të cilësisë së vendimmarrjes si dhe të rritjes së efektivitetit të përcjelljes së politikave të saj në ekonomi, Banka e Shqipërisë angazhohet të rritë më tej bashkëpunimin e saj me institucionet e tjera përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave ekonomike. Rëndësi të veçantë do të marrë rritja e koordinimit me politikën fiskale, nëpërmjet shkëmbimit të vazhdueshëm të parashikimeve dhe opinioneve me Ministrinë e Financave mbi gjendjen aktuale dhe të pritur të ekonomisë. Po ashtu, rritja e bashkëpunimit me INSTAT do të mbetet përparësi e këtij programi afatmesëm, duke synuar përmirësimin sasior dhe cilësor të statistikave ekonomike financiare në vend, si dhe publikimin e tyre në përputhje me standardet më të përparuara ndërkombëtare. Së fundi, përparësi e mëtejshme e punës sonë do të jetë rritja e bashkëpunimit me institucionet e tjera mbikëqyrëse e rregullatore të sistemit financiar shqiptar, në funksion të njësimit të standardeve dhe praktikave dhe të forcimit të stabilitetit financiar të vendit.

Banka e Shqipërisë ka konsoliduar tashmë një traditë pozitive bashkëpunimi dhe dialogu me industrinë bankare, e cila ka në fokus identifikimin e çështjeve madhore me ndikim në stabilitetin e sistemit bankar dhe trajtimin e problematikave me rëndësi për banka individuale. Në këtë kuadër, janë institucionalizuar forume me sektorin bankar për vendosjen e një komunikimi me përfitim të ndërsjellë si në ngritjen dhe vlerësimin e shqetësimeve nga ana e Bankës së Shqipërisë, ashtu edhe trajtimin e çështjeve me interes edhe për industrinë bankare. Përmirësimet dhe ndryshimet rregullatore kanë përfshirë mendimet e industrisë bankare, duke sjellë si rezultat akte rregullative që i përgjigjen efektivisht dinamikave të tregut. Gjithashtu, komunikimi me sistemin bankar ka synuar ndërmarrjen e nismave për përmirësimin e infrastrukturës financiare, ndërkohë që një vëmendje e veçantë i është kushtuar cilësisë së qeverisjes së bankave, transparencës bankare dhe mbrojtjes së konsumatorit.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

- Krijimi i një imazhi të ri vizual të Bankës së Shqipërisë, duke u bazuar në një koncept konciz dhe të vazhdueshëm, i cili do të pasqyrojë tre shtyllat ku mbështetet institucioni: besueshmërinë, transparencën dhe përgjegjshmërinë, si dhe do të identifikojë Bankën e Shqipërisë prej institucioneve të tjera.
- Përmirësimi dhe analizimi i faqes zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë.
- Përdorimi i formave të reja të komunikimit me publikun nëpërmjet pjesëmarrjes në disa media sociale.

Realizimi i objektivave strategjikë në fushën e komunikimit do të bëhet i mundur nëpërmjet:

- Krijimit të një imazhi të ri institucional nëpërmjet rikonceptimit të elementëve kryesore që përbëjnë imazhin e institucionit.

Krijimi i një imazhi unik qëndron në identifikimin e institucionit, në këtë rast të Bankës së Shqipërisë, nga institucionet e tjera. Për këtë arsye, ai do të jetë sa më i thjeshtë e serioz, duke shprehur funksionet kryesore të Bankës së Shqipërisë në përgjithësi dhe duke shmangur ndërlikimet në të kuptuarin e tij prej publikut të gjerë.

Elementet e imazhit të ri institucional do të jenë:

- logoja e re e Bankës së Shqipërisë;
- skema e ngjyrave të përdorura në komunikimin elektronik dhe jo elektronik;
- grafika e komunikimit elektronik dhe jo elektronik;
- tipografia e përdorur në komunikimin elektronik, jo elektronik, zyrtar dhe jozyrtar të institucionit;
- faqosja e materialeve të komunikimit elektronik, jo elektronik, zyrtar dhe jo zyrtar të institucionit;
- shëmbëlltyra vizuale elektronike dhe jo elektronike e institucionit.

Të gjitha elementet përbërëse të imazhit të ri institucional, do të zbatohen dhe integrohen në të gjitha kanalet e komunikimit të Bankës së Shqipërisë, si: në faqen e internetit, publikimet, prezantimet publike dhe ato të brendshme, axhendat, kalendarët etj..

Për realizimin e imazhit të ri institucional Banka e Shqipërisë do të zhvillojë një konkurs të hapur, me qëllim përzgjedhjen e idesë më të mirë në përcjelljen e imazhit të saj institucional.

• RIKONCEPTIMI I FAQES SË INTERNETIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË DHE ANËTARËSIMI NË MEDIA SOCIALE

Faqja zyrtare e internetit është fytyra publike e një banke qendrore. Cilësia, paraqitja vizuale dhe lehtësia në përdorimin e saj ndikojnë perceptimin publik në lidhje me institucionin. Rrjedhimisht, faqja zyrtare e Bankës së Shqipërisë duhet të përcjellë filozofinë e komunikimit të institucionit. Imazhi i ri institucional duhet të integrohet tërësisht edhe në faqen e saj të internetit.

Gjithashtu, për sa i përket teknologjisë së komunikimit, Banka e Shqipërisë do të marrë pjesë në disa prej rrjeteve sociale, me qëllim përçimin e informacionit

te një publik më i gjerë, si dhe tek ata që përçojnë informacion për shkak të profesionit që ushtrojnë, si kërkuesit dhe gazetarët.

Kryerjes së analizave statistikore të faqes së internetit të Bankës së Shqipërisë:

Faqja e internetit të Bankës së Shqipërisë do të analizohet nëpërmjet zbatimit të një programimi specifik për analizimin e web-it, nëpërmjet të cilit mund të merren të dhëna mbi numrin e vizorëve në rubrika të ndryshme të faqes së internetit, kohëzgjatjen e vizitave në secilën rubrikë dhe të dhëna demografike si dhe gjeografike të vizitorëve.

- ## EDUKIMI FINANCIAR

Që prej vitit 2006 Banka e Shqipërisë është angazhuar në zbatimin e programeve të edukimit financiar, duke u kthyer në një institucion lider kombëtar në këtë fushë. Qytetarët shqiptarë do të ndihmohen të kuptojnë si duhet faktorët ekonomikë dhe financiarë që ndikojnë jetët e tyre dhe të jenë pjesëmarrës aktivë në ekonominë e vendit. Banka e Shqipërisë bashkëpunon me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare për të ngritur një platformë gjithëpërfshirëse të edukimit financiar, të përshtatur edhe me nevojat e sistemit arsimor vendas.

Objektivi strategjik:

- Rritja e kulturës financiare në vend.

Realizimi i objektivit në fushën e edukimit financiar do të bëhet i mundur nëpërmjet:

- Integrimit të koncepteve dhe njohurive bazë të edukimit financiar në kurrikulën e rishikuar bërthamë të arsimit bazë (9-vjeçar), në bashkëpunim me Institutin e Zhvillimit Arsimor (IZHA).
- Hartimit të paketave mësimore mbi çështje të edukimit financiar për nxënësit e shkollave 9 vjeçare, në përputhje me rekomandimet e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) dhe në bashkëpunim me IZHA-n. Këto paketa do të shpërndahen falas, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH).
- Hartimit të librit me ushtrime të zgjidhura për mësuesit e modulit me zgjedhje "Financat personale në duart tuaja", i cili u bë pjesë e kurrikulës së arsimit të mesëm në vitin shkollor 2011-2012. Shpërndarja e librit do të shoqërohet me seminare trajnuese për mësuesit.
- Zhvillimit të një metodologjie për matjen e efektivitetit të programeve të edukimit financiar të Bankës së Shqipërisë për sistemin arsimor, në përputhje me praktikat e OECD-së.

- Kryerjes së vrojtimit të dytë kombëtar për matjen e nivelit të njohurive financiare të popullatës së rritur në Shqipëri, në bashkëpunim me INSTAT. Metodologjia e vrojtimit do të bazohet në udhëzimet e Rrjetit Ndërkombëtar mbi Edukimin Financiar (INFE) të OECD-së, me qëllim krahasimin e të dhënave me ato të shteteve të tjera.

• KRIJIMI I MUZEUT TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Në kuadër të projektit për rikonstruksionin e ndërtesës qendrore të Bankës së Shqipërisë, mundësohen ambiente të përshtatshme për krijimin e një muzeu modern me funksione të integruara numizmatike, historike dhe edukuese. Kompozimi dhe projektimi i muzeut do të respektojë arkitekturën karakteristike të Bankës, shoqëruar me mobilim funksional estetik dhe me skenografi arkitektonike muzeore. Funksionaliteti muzeor do të plotësohet nëpërmjet infrastrukturës inxhinierike dhe teknikaliteteve të ndryshme të ndriçimit, ajrimit, sigurimit të objekteve dhe teknologjisë informatike.

Banka synon të zbatojë përvojat më të mira në krijimin e muzeve të ngjashëm nëpërmjet përzgjedhjes së një studioje prestigjioze në realizimin e projekteve të tilla.

Për këtë qëllim, do të përshtaten të gjitha aktet rregullative sipas standardeve bashkëkohore. Gjithashtu, Banka do të zhvillojë më tej praktikat e shtypjes së monedhave numizmatike, për të prezantuar nëpërmjet dizenjove të tyre sa më tepër ngjarje të rëndësishme, personalitete, vlera historike, kulturore, arkitektonike, etj. Në mbështetje të funksionalitetit të muzeut do të kryhet dhe dixhitalizimi i të gjitha vlerave numizmatike.

Objektivat e synuara përmes krijimit të muzeut janë:

- Rritja e informimit të publikut mbi objektivat, funksionet dhe aktivitetin e Bankës së Shqipërisë, si dhe rolin e saj mbi ekonominë e vendit.
- Shpalosja e përmbajtjes së fondit numizmatik dhe historik të Bankës së Shqipërisë.
- Ndërgjegjësimi i vizitorëve për vlerat historike dhe kulturore që monedhat e kartëmonedhat mbartin në vetvete dhe për historikun e Bankës së Shqipërisë.
- Organizimi i veprimtarive me natyrë historike, kulturore dhe artistike për publikun e gjerë.
- Përmirësimi i veprimtarisë numizmatike të Bankës së Shqipërisë, duke rritur mundësinë e publikut për t'u njohur me monedhën tonë kombëtare.

Muzeu pritet të përfundojë brenda vitit 2013. Paralelisht me përfundimin e rikonstruksionit të ndërtesës do të fillojë funksionimi i muzeut, si qendër e hapur

për vizitorë. Pritja e publikut dhe tregtimi i vlerave numizmatike do të kryhen brenda mjediseve të muzeut. Në vitet në vijim do të synohet përfshirja e muzeut në organizmat ndërkombëtarë të muzeve.

Gjithashtu, Muzeu do t'i shërbejë edukimit të publikut mbi koncepte themelore të bankingut qendror dhe financave personale. Për periudhën afatmesme puna për ngritjen e Muzeut do të konsistojë në realizimin e një konkursi ndërkombëtar për dizenjimin, projektimin dhe ndërtimin e një muzeu bashkëkohor, me qëllim sjelljen e përvojës më të mirë në këtë fushë. Periudha trevjeçare pas ngritjes, do të vijojë me fushatën promovuese për njohjen e publikut me Muzeun e ri si dhe me ideimin e programeve për të mirëpritur për herë të parë brenda bankës qendrore, publikun e gjerë të çdo grupmoshe.

INTEGRIMI EVROPIAN

Objektivat themelorë të Bankës së Shqipërisë në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integrimit evropian dhe përafrimi ligjor e rregullativ me acquis-në e Bashkimit Evropian do të fokusohen kryesisht në:

- monitorimin e pjesës legjislative të Masterplanit të Bashkimit Evropian;
- përmbushjen e detyrimeve të Bankës së Shqipërisë që rrjedhin nga dokumentet strategjike të integrimit evropian;
- realizimin e detyrimeve të Bankës së Shqipërisë në kuadër të strukturave të përbashkëta BE-Shqipëri, të ngritura për mbikëqyrjen e zbatimit dhe realizimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit;
- adresimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian në lidhje me përafrimin ligjor dhe institucional;
- përvetësimin dhe zbatimin e praktikave më të mira të koordinimit institucional dhe ndërinstitucional të bankave qendrore në BE;
- zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me Sistemin Evropian të Bankave Qendrore;
- koordinimin e ndihmës financiare nga BE, sidomos programi Taiex. Programe të tjera: twinning light;
- informimin e publikut për çështjet e integrimit evropian në fushën bankare, liberalizimin e kapitalit dhe adoptimin e euros;
- forcimin e rolit dhe cilësisë së përkthimit të akteve ligjore të BE-së në shqip dhe akteve të Bankës në anglisht;
- ndërtimin e kapaciteteve brenda Bankës për përballimin e sfidave të integrimit evropian.

Masat kryesore që do të ndërmerren me synim realizimin e objektivave themelorë të Bankës së Shqipërisë për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integrimit evropian do të jenë:

- identifikimi dhe përdorimi i versioneve të konsoliduara të akteve përkatëse të acquis-së së BE-së me ndryshimet përkatëse;
- hartimi i tabelave të përputhshmërisë me qëllim identifikimin e nivelit të përafrimit të legjislacionit bankar me atë të BE-së si dhe shqyrtimi i relacioneve shoqëruese për projektaktet e Bankës që parashikohen të përafrohen me një akt të BE-së;
- monitorimi dhe zbatimi efektiv i detyrimeve që rrjedhin nga dokumentet strategjike të integrimit evropian si: Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit,

Partneriteti Evropian dhe progres raportet e Komisionit Evropian;

- bashkërendimi i procesit të punës brenda Bankës së Shqipërisë me synim hartimin e kontributeve për strukturat e përbashkëta BE-Shqipëri të ngritura për mbikëqyrjen e zbatimit dhe realizimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit si: Këshilli i Stabilizim Asocimit, Komiteti i Stabilizim Asocimit dhe nën-komitetet përkatëse.

BURIMET NJERËZORE

Në zbatim të "Strategjisë afatmesme të zhvillimit të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2009-2011", në fushën e burimeve njerëzore, u angazhuam në rritjen e nivelit të kualifikimit dhe trajnimit të punonjësve; rritjen e nivelit akademik; orientimin e Bankës së Shqipërisë drejt një institucioni jo vetëm me profil administrativ, por edhe kërkimor. Gjatë kësaj periudhe u ngrit dhe u konsolidua infrastruktura e duhur rregullative dhe administrative për, zhvillimin profesional të stafit, menaxhimin e karrierës dhe konsolidimin e mëtejshëm të punës kërkimore në Bankën e Shqipërisë, nëpërmjet hartimit të bazës rregullative dhe ndryshimeve organizative në strukturat përkatëse dhe përgjegjëse në arritjen dhe zbatimin e objektivave strategjikë.

Institucioni ynë vlerëson se arritja e objektivave të mësipërm është një proces i vazhdueshëm dhe i rëndësishëm për performancën e qëndrueshme dhe përmbushjen e objektivit ligjor të Bankës së Shqipërisë.

Punonjësit e Bankës së Shqipërisë janë një nga asetet më të rëndësishme dhe vitale të saj. Forcimi dhe ruajtja e një mjedisi pune motivues për punonjësit, rritja profesionale dhe menaxhimi i karrierës së tyre ndihmon krijimin e një kulture pune dhe operacionale të aftë për t'u përshtatur në mënyrë të vazhdueshme me ndryshimet që kërkohen për arritjen e standardeve më të mira për një bankë qendrore. Gjithashtu, mbështet një qëndrueshmëri dhe vazhdueshmëri afatgjatë të kapaciteteve administrative dhe të punës në Bankë.

Arritja e objektivave të mësipërm kërkon të ndërmerren iniciativat e mëposhtme:

- forcimi i sistemit të vlerësimit të performancës drejt motivimit të personelit duke u bazuar në rezultatet e punës së gjithsecilit, si dhe kompetencave të duhura për kryerjen e punës;
- zhvillimi i kualifikimeve profesionale të punonjësve;
- krijimi i kushteve të nevojshme dhe nxitja e rritjes në mënyrë cilësore të punës kërkimore;
- organizimi i trajnimeve me qëllim zhvillimin e aftësive menaxheriale e drejtuese të menaxherëve të rinj;
- organizimi i trajnimeve për zhvillimin e kompetencave të veçanta për menaxherët aktualë;
- matja e pëlqimit të jetës në punë të punonjësve.

Impakti i pritur nga masat e mësipërme është rritja e efikasitetit dhe eficiencës së veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë për arritjen e mëtejshme të standardeve të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore.

BURIMET FINANCIARE

Objektivat e Bankës së Shqipërisë në fushën e burimeve financiare janë:

- **PËRAFRIM I RAPORTIMEVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR**

Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar është një objektiv madhor. Zbatimi i tyre lidhet ngushtë me të gjithë punën operacionale dhe administrimin e të dhënave në Bankën e Shqipërisë, sistemet informatike dhe përmirësimin e tyre, strukturën mbështetëse organizative, ndjekjen dhe kontrollin e riskut operacional, rritjen e nivelit të kualifikimit të punonjësve si dhe tregimin e kujdesit të duhur në të gjitha fushat.

Tregues për arritjen e këtyre standardeve janë eliminimi i shmangieve të evidentuara prej auditorëve të brendshëm dhe të jashtëm, afatet kohore të përcaktuara për përmirësimet e kërkuara dhe vlerësimi për arritjen e tyre nga auditorët e certifikuar.

- **RISHIKIMI I MANUALIT EKZISTUES KONTABËL TË BANKËS SË SHQIPËRISË DHE HARTIMI I NJË MANUALI TË RI KONTABËL**

Nevoja për rishikimin e manualit kontabël të Bankës së Shqipërisë ka lindur nga zhvillimet legjislative dhe ato të ndodhura brenda institucionit. Kështu, në ndjekje të praktikave të bankave të tjera qendrore, janë shtuar instrumentet financiare të përdorura, duke aplikuar një shumëllojshmëri transaksionesh dhe krijuar situata të reja financiare nga ato të përshkruara në manualin e mëparshëm. Gjithashtu, ky rishikim do të realizohet edhe nga nevoja për një transparencë më të madhe ndaj përdoruesve të informacionit financiar të prodhuar nga Banka e Shqipërisë.

Manuali i ri do të reflektojë ndryshimet e ndodhura në vite në organizimin e Bankës së Shqipërisë, marrëveshjet dhe partnerët e saj, instrumentet e procedurat e reja. Ky manual do të konsultohet edhe me ekspertë të fushës.

Manuali i ri i kontabilitetit pritet të përfundojë brenda vitit 2013.

- **RRITJA E EFICENCËS SË PËRDORIMIT TË BURIMEVE FINANCIARE**

Rritja e eficencës do të realizohet përmes:

- forcimit të masave për miradministrimin e aktiveve të qëndrueshme nëpërmjet: rishikimit të akteve rregullative, normave të amortizimit dhe rivlerësimit të aktiveve;
- ndjekjes së të drejtave dhe detyrimeve të Bankës së Shqipërisë, duke pasur synim eliminimin e pozicioneve në pasqyrën e pozicionit financiar më të hershme se 1 vit dhe llogaritjet dhe mbajtjen e provigjoneve;
- rishikimit të rregulloreve që lidhen me degët dhe me vlerat monetare të Bankës së Shqipërisë; hartimi i procedurave për marrëdhëniet e reja me bankat lidhur me cash-in në kujdestari; hartimi i procedurave të reja për ekspozimin e vlerave numizmatike në publik nëpërmjet organizimit të ekspozitave, etj.

- **FORCIMI I PAVARËSISË SË QENDRAVE TË KOSTOS**

Banka e Shqipërisë, në zbatim të praktikave më të mira të ndjekura nga bankat qendrore, synon forcimin e pavarësisë së qendrave të kostos nëpërmjet:

- përmirësimit të procesit të hartimit dhe ndjekjes së buxhetit, me synim përafrimin e treguesve të buxhetit të planifikuar me realizimin faktik;
- forcimit të bashkëpunimit ndërmjet qendrave të kostove, për realizimin e projekteve të buxheteve në afat dhe respektimin e detyrave sipas projekteve të planifikuara;
- automatizimit të proceseve që realizojnë ndjekjen e raportimin e buxhetit, nëpërmjet përdorimit të nënmodulit të buxhetit dhe reduktimit të mbajtjes manuale;
- forcimit të kontrollit të brendshëm të veprimeve të Bankës me korrespondentët e huaj.

Për shkak të rritjes së veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë dhe marrjes pjesë në një sërë projektesh me synim administrimin më të mirë të rezervave të saj, gjatë periudhës 2013-2015 do të synohet edhe automatizimi i plotë i kontrollit të veprimeve në valutë, nëpërmjet implementimit të sistemeve të reja informatike që do të eliminojnë plotësisht veprimet manuale.

BURIMET MATERIALE

NDËRTESA QENDRORE

Ndërtesa qendrore e Bankës, e vendosur në qendër të sheshit "Skënderbej",

përfaqëson në mënyre dinjitoze një nga institucionet më të rëndësishme të vendit. E ndërtuar rreth 70 vjet më parë, kjo godinë qëndron si një vepër arti dhe mbrohet nga shteti si pjesë e qendrës së kryeqytetit, e shpallur Ansambël Monument Kulture. Ndërkohë që Banka zhvillohej me ritmin e kohës, ndërtesa ku ajo ushtron aktivitetin vazhdonte të ishte ajo e 70 viteve më parë. Si rrjedhim, ndërtesa nuk mund të plotësonte edhe kërkesat më minimale: akomodimin në mjedise pune të punonjësve të Bankës, ndërkohë që mungonin mjediset për veprimtari të tjera të natyrës parësore, përfaqësuese dhe ndihmëse si salla mbledhjesh, konferencash, bibliotekë, muze, etj.

Në këtë mënyrë, domosdoshmëria e rikonstruksionit dhe restaurimit të ndërtesës lindi si realizim i kërkesës kryesore për rritjen e funksionalitetit të mjediseve të veprimtarive të Bankës, si dhe rikthimit në origjinalitet të ndërtesës ekzistuese. Rikonstruksioni do të shoqërohet me ndërtimin e një shtese në krahët jugorë dhe perëndimorë të oborrit, një kompleks i ri, lartësia e të cilit do të jetë sa ajo e ndërtesës ekzistuese. Kjo nevojë e Bankës gjeti mbështetje dhe në planin rregullues të qendrës së qytetit të Tiranës.

ISH-HOTEL "DAJTI"

Zhvillimet e vrullshme sasiore dhe cilësore që kanë shoqëruar veprimtarinë e Bankës në këto vitet e fundit, kanë bërë që kërkesat për hapësira ndërtimore për të ushtruar aktivitetin e saj ditor të rriten në vazhdimësi. Ushtrimi i shumë prej funksioneve unike të përfaqësimit, kërkesat funksionale gjithnjë e në rritje, angazhimet e shumta të Bankës në veprimtaritë ndërkombëtare, kërkesat e domosdoshme teknologjike të informacionit dhe një sërë arsyesh të tjera diktonin nevojën për mjedise shtesë. Në këto kushte, blerja e ndërtesës së ish-Hotel "Dajtit", përbën një nga lëvizjet strategjike të Bankës për një zgjidhje afatgjatë dhe dinjitoze në sigurimin e mjediseve të punës që do të plotësojnë infrastrukturën e ndërtesës qendrore.

I ndërtuar rreth viteve '30, ish-Hotel "Dajti" ndahet në një distancë shumë të shkurtër me ndërtesën qendrore dhe, me sipërfaqen e tij të madhe dhe vendndodhjen fizike, plotëson nevojat e Bankës për mjedise pune dhe për transparencë e afërsi me publikun. Banka ka hartuar planet për funksionimin e ndërtesës në shërbim të veprimtarisë së saj, të cilat parashikojnë rikthimin e ndërtesës në të gjitha aspektet e saj në gjendjen fillestare, ringjalljen e këtij objekti dhe kthimin e shkëlqimit të dikurshëm. Restaurimi do të kryhet në përputhje me idetë fillestare të arkitekturës së godinës, por natyrisht në kushtet e shekullit të ri, pa harruar edhe mjedisin e gjelbëruar përreth tij. Kjo ndërtesë me bibliotekën e pasur të saj do të jetë një dritare e kontaktit të drejtpërdrejtë me publikun, veçanërisht me kërkuesit, akademikët, studentët dhe median.

NDËRTESA E EMISIONIT

Në kuadër të intensifikimit të punës operacionale dhe organizimit të proceseve të rëndësisë së veçantë në lidhje me emetimin e parasë, Banka është pranë finalizimit të ndërtesës së re për administrimin dhe ruajtjen e monedhave. Kjo është një qendër moderne pranë qytetit të Tiranës që ka përfshirë të gjitha aspektet operacionale të administrimit dhe përpunimit të monedhës në një pikë të vetme, duke rritur kështu eficiencën e Bankës në këtë drejtim. Kjo ndërtesë mishëron të gjithë arkitekturën moderne dhe normativat evropiane të fushës, duke reflektuar edhe kontributin konkret dhe të prekshëm të Bankës në ruajtjen dhe promovimin e vlerave arkitekturore shqiptare.

Me përfundimin e investimeve në këto objekte, modeli institucional i Bankës do të përafrohet akoma më shumë me atë të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore. Nga ana tjetër, do të jetë një kontribut i jashtëzakonshëm në ruajtjen dhe evidentimin e trashëgimisë kulturore të qytetit të Tiranës si dhe në nxitjen cilësore të aktivitetit edukativo-shkencor të vendit në fushën e bankingut qendror e financave.

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Bashkëpunimi me bankat qendrore dhe institucionet financiare ndërkombëtare në periudhën 2013-2015 do të përqendrohet kryesisht në:

- **MARRËDHËNIET ME BANKAT QENDRORE DHE ASISTENCËN TEKNIKE**

Gjatë periudhës 2013-2015, Banka e Shqipërisë do të synojë të vazhdojë intensifikimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe bashkëpunimin teknik të vendosur me bankat qendrore të Evropës Juglindore dhe më gjerë, duke përfshirë këtu dhe bankat anëtare të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore. Krahas zhvillimit të mëtejshëm të marrëdhënieve me institucionet homologe, Banka e Shqipërisë synon gjithashtu përfitimin e asistencës teknike me qëllim forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale.

Më konkretisht, asistenca teknike do të synohet në format e vizitave studimore, seminareve dhe praktikave të punës pranë bankave qendrore dhe autoriteteve mbikëqyrëse të rajonit dhe më gjerë, dhe sidomos pranë Bankës së Shqipërisë, në përputhje me objektivat strategjikë të institucionit.

Në kuadër të procesit të integrimit evropian, përkatësisht në lidhje me procesin e përafrimit ligjor, institucional dhe operacional me Bankën Qendrore Evropiane dhe SEBQ-në, do të vazhdojë të jetë me rëndësi thithja e përvojave të bankave

qendrore të Evropës Qendrore dhe Lindore, të anëtarësuara në SEBQ gjatë periudhës 2004-2007 si dhe bankave qendrore të vendeve kandidate për anëtarësim në BE.

Gjatë periudhës së viteve 2013-2015, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të përforcojë marrëdhëniet dhe bashkëpunimin me bankat qendrore të Evropës Juglindore dhe më gjerë, duke marrë pjesë aktive në takimet që do të organizohen në kuadër të Klubit të Guvernatorëve të bankave qendrore të vendeve të Azisë Qendrore, të rajonit të Detit të Zi dhe Ballkanit, Klubit të Guvernatorëve të bankave qendrore frankofone, takimeve të Fondit Evropian për Evropën Juglindore etj.

Banka e Shqipërisë do t'i kushtojë një rëndësi të veçantë marrëdhënieve me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, duke vijuar zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit dhe duke ofruar trajnime të rregullta me qëllim shkëmbimin e përvojave në fushën e bankingut qendror.

- **BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET FINANCIARE NDËRKOMBËTARE**

Në periudhën 2013-2015, një tjetër objektiv i rëndësishëm i Bankës së Shqipërisë do të mbetet zhvillimi dhe përforcimi i marrëdhënieve me institucionet financiare ndërkombëtare si Fondi Monetar Ndërkombëtar, Grupi i Bankës Botërore, Banka për Rregullime Ndërkombëtare, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim etj.

Nga FMN-ja do të synohet vazhdimi i asistencës teknike në fushat e politikës monetare, mbikëqyrjes bankare, modelimit makroekonomik dhe parashikimit të inflacionit, përpilimit të të dhënave statistikore, zbatimit të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe pagesave, etj.

Në të njëjtën kohë, edhe nga Grupi i Bankës Botërore do të synohet vazhdimi i asistencës teknike në administrimin dhe konsulencën e investimit të rezervës valutore; nga ku parashikohet vënia në zbatim e programit PATII (Portfolio Analytics Tool II) për përmirësimin e infrastrukturës të teknologjisë së informacionit në mbështetje të procesit të administrimit të rezervës valutore. Gjithashtu, synohet vazhdimi i asistencës në fushën e mbikëqyrjes bankare, duke e përqendruar bashkëpunimin në kontekstin e administrimit të rrezikut të kredisë dhe çështjes së kredive me probleme.

Krahas bashkëpunimit me institucionet e ndryshme ndërkombëtare, gjatë këtyre viteve, do të synohet zbatimi me sukses i Programit për Zhvillimin e Sektorit Financiar në bashkëpunim me FSVC (Financial Services Volunteer Corps), i cili ka për qëllim përsosjen e mëtejshme të njohurive në funksion të rritjes së kapaciteteve njerëzore.

Në të njëjtën kohë, gjatë periudhës 2013-2015, duke u bazuar në marrëdhëniet shumë të mira me Bankën për Rregullime Ndërkombëtare (BIS), Banka e Shqipërisë do të synojë vazhdimin e angazhimit aktiv në këtë institucion, nëpërmjet pjesëmarrjes me statusin e vendit vëzhgues në forumet e BIS-it. Do të synohet pjesëmarrja e stafit të Bankës së Shqipërisë në seminaret dhe trajnimet në fushën e mbikëqyrjes së sistemit financiar organizuar nga Instituti i Stabilitetit Financiar, asistencë në drejtim të standardizimit të rregullave të mbikëqyrjes për segmente të ndryshme të sektorit financiar dhe çështjeve që kanë të bëjnë me qeverisjen e bankave qendrore.